



REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.DH.Shk II.nr.364/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbare të “Embelsia M&A”, SH.P.K., me NUI:810100769, me seli në Çabër, Zubin Potok, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me NUI: 810112186, me seli në Prishtinë, rruga “Aziz Abrashi”, pn, përfaqësuar sipas autorizimit nga G.R., duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.535/23 të datës 01.09.2023, me datë **16.04.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Embelsia M&A”, SH.P.K., me seli në Çabër, Zubin Potok, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 535/23 të datës 01.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 535/23 të datës 01.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të “The North Unicorn” L.L.C., të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbare 52/2022 i datës 22.06.2022 të Përmbaresit Privat Ilmi mIftaraj, dhe i njëjti Urdhër Shfuqizohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 535/23 të datës 01.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Embelsia M&A”, SH.P.K., me datën 22.06.2022, ka paraqitur propozimin për përmbartim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.011401 të datës 23.05.2021 dhe faturës nr.0067502 të datës 12.07.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor 52/2022 të datës 22.06.2022, me të cilin është cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit kryesor të ia paguaj kreditorit shumën prej 2,000.00 €, me kamatëvonesë prej 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të propozimit e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit. Përmbartimi të realizohet me bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e mjeteve në llogaritë bankare të përmbartuesit privat dhe nga kjo llogari të bëhet transferi në llogarinë e kreditorit. Nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë bankare përmbartimi të realizohet përmes sekuestrimit dhe shitjes të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësimin, duke kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se e karakterizon parregullsia në përmbartjen e tij, sepse kreditori ka paraqitur si dokumente të besueshme dy fatura të cilat nuk janë pranuar nga debitori, ose janë pranuar nga ndonjë person i paautorizuar më çka cenon rëndë kredibilitetin dhe bazën ligjore të këtij urdhri përmbartues. Ka shtuar se për faturat e pranuar dhe për borxhin e njoftuar në mënyrë të rregullt është në vazhdimësi duke realizuar pagesa siç dëshmohet nga transaksionet bankare të realizuar në shumë totale prej 2,000.00 €, e që në fakt flet për seriozitetin dhe vullnetin e mirë të debitorit. Po ashtu ka theksuar se kartela financiare e kreditorit e bashkangjitur me propozimin për

përbarim është e pavërtetuar e për më tepër e pa barazuar me debitorin dhe e njëjta nuk përbën dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të caktoj seancë dëgjimore lidhur me paqartësinë që e karakterizon propozimin përbarimor dhe të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përbarimor P.nr.52/2022 i datës 22.06.2022, lejuar nga përbaruesi Ilmi Miftaraj. Po ashtu Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka deklaruar se dy faturat e paraqitura te përbaruesi i ka të vulosura dhe të nënshkuara nga ana e debitorit. Sa i përket pretendimit të debitorit për parregullsi dhe për mos besueshmëri të faturave ka deklaruar se të njëjtat nuk qëndrojnë për faktin se ato janë të nënshkuara dhe të vulosura që do të thotë se vula e cila është në faturë nuk mund të jetë jo valide. Më tutje ka shtuar se debitori e ka kryer një pjesë të obligimit të këtyre faturave, ndërsa pjesën tjetër të pagesës refuzon ta paguaj me arsyetimin se faturat janë të parregullta dhe jo valide, me ç'rast debitori bie në kundërshtim me vetveten sepse veç e ka kryer një pjesë të pagesës të faturave në fjalë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe urdhri për përbarim P.nr. 52/2022 i datës 22.06.2022, i përbaruesit privat Ilmi Miftaraj, të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: “Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit. 2. Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”, ndërsa sipas nenit 37 përcaktohet se: “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar shkalla e parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase propozimi për përmbartim është paraqitur në bazë të dokumenteve të besueshme, përkatësisht Faturës nr.011401 të datës 23.05.2021 në shumën prej 2,555.00 € dhe Faturës nr.0067502 të datës 12.07.2021 në shumën prej 3,686.50 €, ndërsa propozimit për përmbartim nuk i janë bashkëngjitur faturat e lartcekura, mirëpo i janë bashkëngjitura fatura nr.6543 e datës 03.09.2021 në shumë prej 401.50 € dhe fatura nr.76433 në shumë prej 65.74 €, të cilat nuk janë dokumentet e besueshme në bazë të të cilave është inicuar kjo procedurë, përkatësisht nuk përputhen me faturat e paraqitura në propozim as sa i përket numrave të faturave, as sa i përket shumës së kërkuar në propozimin për përmbartim. Prandaj meqenëse propozimit për përmbartim nuk i janë bashkëngjitur dokumentet e besueshme në bazë të të cilave është kërkuar caktimi i përmbartimit, mirëpo i janë bashkëngjitur dokumente tjera të cilat nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje përmbartimore, rezulton se propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 37 dhe nenin 38 të LPP-së.

Tutje gjykata e shkallës e parë thekson se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase të njëjtit nuk i janë bashkëngjitur dokumentet e besueshme dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës gjeti se faturat e paraqitura në propozim nuk përputhen as sa i përket numrave të faturave, dhe sa i përket shumës së kërkuar në propozimin për përmbarim. Andaj faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.364/24, me datë 16.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti